



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 213, Datë 28.07.2026

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR SHQYRTIMIN E
KËRKESËS SË SHOQËRISË “HIDROINVEST 1” SH.P.K. PËR ZGJIDHJEN E
MOSMARRËVESHJES ME SHOQËRINË OSSH SH.A., LIDHUR ME
KONFIGURIMIN TEKNIK TË LIDHJEVE 35 KV NË TRANSFORMATORIN TR-1
TË NËNSTACIONIT PRRENJAS**

Në mbështetje të neneve 16, 20 gërmat “a” dhe “ë”, 26, pikat 1, 2 dhe 3, të ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 15 dhe 23 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, datë 03.09.2016; nenit 11 të Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.07.2026, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve me nr. 471/5 prot., datë 27.07.2026, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Hidroinvest 1” sh.p.k. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë “OSSH” sh.a., lidhur me konfigurimin teknik të lidhjeve 35 kV në transformatorin TR-1 të nënstacionit Prrenjas”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Hidroinvest 1” sh.p.k., me shkresën nr. 7 prot., datë 30.01.2026, të protokolluar pranë Entit Rregullator të Energjisë (ERE) me nr. 471 prot., datë 03.02.2026, i është drejtuar ERE-s me kërkesë për zgjidhje mosmarrëveshjeje të lindur me Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., lidhur me konfigurimin teknik të lidhjes në tensionin 35 kV në nënstacionin Prrenjas, ku janë lidhur centralet e shoqërisë “Hidroinvest 1” sh.p.k. (HEC Stranik dhe HEC Zall Tore) në transformatorin TR-1 (110/35/6 kV, 20 MVA), si dhe mosfunksionimin e mbrojtjes diferenciale të këtij transformatori.
- Sipas shoqërisë “Hidroinvest 1” sh.p.k., problematika buron nga lidhja, në të njëjtin terminal 35 kV të transformatorit TR-1, e një hidrocentrali tjetër (HEC Lingjaca), në pronësi të shoqërisë “Rei-Energji” sh.p.k., e realizuar në mënyrë “kokë-më-kokë”, jashtë standardeve teknike të pranueshme për mbrojtjen diferenciale të transformatorit. Kjo ka shkaktuar një incident në prill të vitit 2024 dhe paraqet rrezik të vazhdueshëm për jetën dhe shëndetin e personelit operativ, si dhe për vazhdimësinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria me shkresën nr. 12, datë 05.06.2024 i është drejtuar Drejtorisë së Tensionit të Lartë si dhe i është drejtuar në mënyrë të përsëritur OSHEE sh.a. nëpërmjet shkresave nr. 12/1, datë 30.01.2025 dhe nr. 12/2 prot., datë 14.05.2025. Me shkresën nr. 6501/4 prot., datë 01.07.2025, OSSH sh.a. i është përgjigjur Drejtorisë së Tensionit të Lartë, duke sqaruar se, në skemën aktuale, është e pamundur zbatimi i mbrojtjes diferenciale të transformatorit TR-1, për shkak të lidhjes “kokë-më-kokë” të dy hidrocentraleve (Hidroinvest 1 dhe Rei-Energji/HEC Lingjaca) në krahun 35 kV të transformatorit.
- Shoqëria i është drejtuar përsëri OSHEE sh.a. me shkresën nr. 12/3 prot., datë 20.11.2025, por pa marrë një zgjidhje konkrete.

- ERE me anë të shkresës nr. 471/1 prot., datë 18.02.2026, ka kërkuar nga OSSH sh.a. informacione dhe shpjegime lidhur me sa pretenduar nga shoqëria “Hidroinvest 1” sh.p.k. duke i lënë një afat prej 10 ditësh për shpjegime/informacione, për të cilën nuk mori përgjigje.
- Në seancën dëgjimore të datës 24.03.2026, përfaqësuesit e OSSH sh.a., deklaruan se mbrojtja diferenciale e transformatorit TR-1 aktualisht nuk funksionon dhe se lidhja e kryer nga HEC “Lingjaca” në krahun 35 kV është jashtë kushteve teknike. OSSH sh.a., ka shprehur gatishmëri për bashkëpunim teknik dhe mbështetje me burime njerëzore për gjetjen e një zgjidhjeje.
- Shoqëria “Hidroinvest 1” sh.p.k. është licencuar për prodhimin e energjisë elektrike me vendimin e ERE-s nr. 113, datë 24.09.2008, ndryshuar me vendimin nr. 6, datë 20.01.2010, ndërsa OSSH sh.a. është operator i licencuar i sistemit të shpërndarjes me vendimin nr. 96, datë 27.10.2014, i ndryshuar me vendimet nr. 216, datë 11.10.2018 dhe nr. 224, datë 09.11.2021.
- Objekti i mosmarrëveshjes së ngritur nga shoqëria “Hidroinvest 1” sh.p.k. lidhur me konfigurimin teknik të lidhjeve në tensionin 35 kV në nënstacionin Prrenjas dhe mosfunksionimi i mbrojtjes diferenciale të transformatorit TR-1, përbën një mosmarrëveshje teknike dhe rregullatore, e cila hyn në fushën e zbatimit të nenit 20, gërma “ë”, dhe nenit 26 të ligjit nr. 59/2026, si dhe të Rregullores së miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 114, datë 08.07.2016.
- Në këto rrethana, vlerësohet se çështja e paraqitur përbën një mosmarrëveshje ndërmjet dy subjekteve të licencuara dhe se palët legjitimohen për t’iu drejtuar ERE-s për zgjidhjen e saj, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës së paraqitur nga shoqëria “Hidroinvest 1” sh.p.k. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë OSSH sh.a., lidhur me konfigurimin teknik të lidhjes 35 kV në nënstacionin Prrenjas dhe mbrojtjen diferenciale të transformatorit TR-1, dhe fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kësaj mosmarrëveshjeje, në përputhje me *Rregulloren për trajtimin e ankesave dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 114, datë 08.07.2016.
2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI